



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 662/8 prot.

Datë 02.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr.459/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit “*E hapur*”, me Nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik, “Zdrava” SHPK me NIPT J84003411K dhe adresë: Fier, Lushnje, Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/20 në zonën kadastrale 3.
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin*”

*dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 27.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Almo Konstruksion & Ina	346,768,983 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	261,45 pikë
BOE Ndrejoni & Rafin Company	355,607,273 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	258 pikë
Zdrava	357,774,473.88 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	257,25 pikë
BOE Alba Konstruksion & O.B.Konstruksion	335,575,230.43 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	255,15 pikë
BOE Senka & G.P.G. Company	338,960,029.95 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	249,30 pikë
Curri	329,537,308 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	241,05 pikë
Arkonstudio	340,994,766.5 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	236,40 pikë
BOE Ante-Group & Nova Construction Group	407,016,484 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	209,10 pikë
Agi Kons	400,000,000.93 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	206,40 pikë
Salillari	430,000,000 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	205,65 pikë
BOE Aurora Konstruksion & Desaret Company	412,013,092.57 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	194,70 pikë
BOE Sterkaj & Eral Construction Company	425,411,174 lekë	Skualifikuar
Dion-Al	332,056,787.67 lekë	Skualifikuar
Llazo	340,064,565 lekë	Skualifikuar
BOE Fled & Shkelqimi 07	332,517,519.59 lekë	Skualifikuar
BOE Nika & Mane/S	350,144,481.68 lekë	Skualifikuar
BOE Lis Konstruksion & Viante Konstruksion	314,167,060.34 lekë	Skualifikuar
BOE Ergi shpk & BE - IS	400,846,043 lekë	Skualifikuar
BOE Kacdedja & Agri Construction	343,758,626.37 lekë	Skualifikuar
BOE Albavia & Inerti	394,279,157.91 lekë	Skualifikuar
Vellezerit Hysa	323,646,519.36 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 14.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/6075 dhe me nr. protokolli 3269/2025, datë 14.11.2025, e operatorit ekonomik “Zdrava” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr.3269/1 prot., datë 17.11.2025.

II.7. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 4653 prot., datë 26.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3269/2 prot., datë 02.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin datë 25.11.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Zdrava” SHPK.Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Në datën 03.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.192/2026 ku vendosi:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Me shkresën nr. 192/3 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr. 3269/9 prot., datë 19.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.192/2026 datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë:

“Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.10. Në datën 19.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.286/2026, ku vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.11. Në datën 26.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit në SPE sipas njoftimit të publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 17, datë 02.03.2026 si vijon:

*“... 3.Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64104-10-08-2025*

*4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Ndërtimi i infrastrukturës së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”.*

*6.Arsyet e Anulimit:*

*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:*

*...*

*X për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;...*

*7. Informacione shtesë:*

*Për shkak të pamundësisë financiare të Bashkisë për realizimin e procesit të shpronësimit, FSHZH nuk mund të vijojë me ecurinë e mëtejshme të procesit të prokurimit për finalizimin e kontratës dhe zbatimin e projektit.*

II.12. Në datën 02.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6376, si dhe nr. protokolli 662/2026 datë 02.03.2026 i operatorit ekonomik, “Zdrava“ SHPK, duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, e konkretisht:

*“[...]*

*VI. Shkaqet e ankimit*

*1) Keqzbatim dhe interpretim i zgjeruar i nenit 98, pika “ç” (shkak përjashtimor, jo “buton shpëtimi”) Neni 98/ç është bazë përjashtimore për anulim dhe kërkon standard provues të lartë, sepse cenon konkurrencën, sigurinë juridike dhe interesin publik. Për t`u aplikuar ligjërsh, duhet kumulativisht: rrethana të paparashikueshme (jo thjesht “ndryshim vullneti”); • rrethana objektive (jo të prodhuara nga vetë AK); • lidhje shkak-pasojë reale: këto rrethana të kenë sjellë ndryshim të provueshëm të nevojave ose aftësisë paguese; dhe kjo të jetë e dokumentuar me akte*

financiare/buxhetore/Thesarit. FShZH nuk ka provuar asnjë nga këto elemente. Ka përdorur vetëm formulimin e ligjit, pa fakte, pa data, pa dokumente, pa tregues financiarë.

2) Akt pa arsytim material dhe pa prova (pavlefshmëri për mungesë motivimi) Anulimi është akt administrativ me pasoja të rënda (shuan një garë publike). Një akt i tillë nuk mund të jetë “një fjali”. FShZH ka detyrim të japë arsytim material, jo citim dispozite. Minimumi i arsyetimit që duhej: • çfarë rrethane ndodhi, kur ndodhi, pse është e paparashikueshme. • si ndryshoi “nevoja” (çfarë s’kërkohet më dhe pse); ose si ndryshoi “aftësia paguese” (çfarë fondi u hoq/ul, me cilin akt). • cilat masa alternative u konsideruan (shtyrje, rishikim planifikimi, fazim), përpara anulimit total. Pa këto, kemi mungesë arsyeje ligjore dhe akt i pambështetur në prova.

3) Kontradiktë direkte me ecurinë e procedurës dhe me planifikimin financiar (logjikë financiare e rrëzuar) Pretendimi “nuk kemi më aftësi paguese” bie ndesh me vetë faktin që procedura: • është planifikuar, është hedhur në prokurim dhe ka ecur në faza të avancuara; • në praktikë, prokurimi publik presupozohet i mbështetur në parashikime buxhetore dhe fonde të alokuara; ndryshimi i aftësisë paguese nuk pretendohet me slogan, por me akt (vendim rishikimi, shkresë Thesari, shkurtim fondesh, bllokim zëri, anulim financimi). Pra, ose fondet nuk kanë ekzistuar kurrë (që do të ishte shkelje e rëndë planifikimi dhe nisje procedure pa mbulim), ose fondet ekzistonin dhe janë “zhdukur” tani me një akt që FShZH po e fsheh. Në të dyja rastet, anulimi siç është bërë është i paligjshëm.

4) Shmangie e vendimeve të detyrueshme të KPP-së (cenim i sigurisë juridike dhe i autoritetit të vendimit) Këtu problemi është edhe më i thjeshtë: pas vendimit nr. 192/2026, FShZH njofton zbatim (shkresa 192/3 prot.) dhe KPP me vendimin nr. 286/2026 lejon vijimin e mëtejshëm të procedurës Pastaj FShZH e anulon procedurën me nenin 98/ç, pa prova. Kjo sjellje, në thelb, është e qarte “po, e zbatoj vendimin e KPP-së... derisa të mos më pëlqejë rezultati, pastaj e anuloj garën”. Ky është abuzim me diskrecionin dhe cenon efektivitetin e ankimit, sepse e bën vendimin e KPP-së praktikisht të pavlefshëm.

5) Shkelje e parimeve të prokurimit publik: barazi, transparencë, proporcionalitet, konkurrencë Anulimi pa arsytim e pa prova cenon: • transparencën (mungon baza faktike), • barazinë dhe konkurrencën (shuan një proces të hapur në fazë të avancuar). • proporcionalitetin (anulimi total pa provuar pse s’mund të ketë zgjidhje më të buta).

6) Praktikë e qëndrueshme: “mungesa e fondeve” kërkon provë formale, jo deklaratë KPP ka mbajtur standard të qartë në raste analoge: kur pretendohet situatë financiare/Thesar, kërkohet verifikim real i fondeve dhe dokumentim. “S’kemi mundësi” nuk është provë. (Kjo është pikërisht arsyeja pse ligji flet për rrethana “objektive” dhe “të paparashikueshme”.)

## VII. KËRKOJMË

Në përfundim, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 dhe rregullave të prokurimit, kërkohet nga KPP:

1. Pranimi i ankesës si e bazuar në ligj dhe në prova. 2. Anullimin i efektit të anulimit, për të mos e bërë të pariparueshëm dëmin dhe për të garantuar efektivitetin e ankimit. 3. Shfuqizimi i vendimit/njoftimit të FShZH për anulimin e procedurës (neni 98/ç), si akt i pambështetur në fakte dhe prova, dhe i paarsyetuar. 4. Urdhërimi i FShZH për vijimin e procedurës nga faza ku ndodhej (pas rivlerësimit të urdhëruar dhe verifikuar nga KPP), në përputhje me vendimet e KPP nr. 192/2026 dhe nr. 286/2026. 5. Detyrimi i FShZH të depozitojë provat që pretendojnë “ndryshim të aftësisë paguese/nevojave”, konkretisht: o aktet e rishikimit buxhetor/financiar, o shkresat e Thesarit/financës (nëse ka bllokim/ulje fondi), o çdo vendim të brendshëm/autoriteti financiar që

*heq fonde, o dhe çdo dokument që provon elementin “paparashikueshmëri” dhe “objektivitet”. 6. Njoftimi i APP për ndjekjen institucionale të rastit (si element integriteti i procesit).*

II.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe u publikua formulari për publikim me nr.662/1 prot., datë 03.03.2025.

II.14. Nëpërmjet shërbimit postar, operatori ekonomik ankimues me shkresën nr.389 prot., datë 02.03.2026, me objekt “Kërkesë zyrtare për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe arsyetimit të plotë për anulimin e procedurës ...”, protokolluar me tonën me nr.3269/14 prot., datë 06.03.2026, ka vënë në dijeni KPP lidhur me kërkesën e bërë autoritetit kontraktor për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.15. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr.929 prot., datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me nr.662/2 prot., datë 17.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin datë 11.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Zdrava” SHA. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.16. Me shkresën nr.866/1 prot., datë 13.03.2026, me objekt “Kthim përgjigje shkresës nr.388 prot., datë 02.03.2026”, protokolluar me tonën me nr.662/3 prot., datë 19.03.2026, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni KPP lidhur me përgjigjen e dhënë ankimuesit për dokumentacionin e kërkuar.

II.17. Me shkresën nr.662/4 prot., datë 25.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor me shkresë duke i kërkuar informacionin si më poshtë: [...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA datë 11.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

*Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, autoriteti kontraktor duhet të dërgojë pranë KPP, kopje të njësuar me origjinalin, të dokumentacionit që ka shërbyer për vendimarrjen e anulimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, e konkretisht:*

- *Marrëveshjen e bashkëpunimit midis FSHZH dhe Bashkisë Divjakë për realizimin e projektit objekt prokurimi;*
- *Shkresën e Bashkisë Divjakë nr.164 prot., datë 08.01.2026;*
- *Shkresën nr.137/1 prot., datë 16.01.2026 të FSHZH;*
- *Vendimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi;*

- Çdo dokument tjetër që është përdorur në marrjen e vendimit për anulim [...].

II.18. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr.929/2 prot., datë 27.03.2026, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr.662/5 prot., datë 30.03.2026, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kopje të njësuar me origjinalin të dokumentacionit të poshtëshënuar:

- Marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkinë Divjakë nr. 10812/1 Prot., datë 15.10.2025, protokolluar nga FSHZH me nr. 4230/1 Prot., datë 15.10.2025;
- Shkresa e Bashkisë Divjakë nr. 164 Prot., datë 08.01.2026, protokolluar nga FSHZH me nr. 137, datë 12.01.2026;
- Shkresa e FSHZH-së nr. 137/1 Prot., datë 16.01.2026 drejtuar Bashkisë Divjakë;
- Shkresa FSHZH-së nr. 137/2 Prot. datë 27.02.2026 - 4 fletë;
- Urdhër për anulimin e procedurës së prokurimit me REF-64104-10-08-2025-1 fletë;
- Njoftimi i Anulimit në Buletin nr.17 datë 2 Mars 2026 - 1 fletë;
- Vendimi i KSHA dërguar me shkresën nr.329 prot., datë 12.03.2026.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimes, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Zdrava” SHPK, mbi kundërshtimin e anulimit të procedurës së prokurimit “*E hapur*”, me Nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 09.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III.1.2. Në datën 27.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datën 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Almo Konstruksion & Ina	346,768,983 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	261,45 pikë
BOE Ndrejoni & Rafin Company	355,607,273 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	258 pikë
Zdrava	357,774,473.88 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	257,25 pikë
BOE Alba Konstruksion & O.B.Konstruksion	335,575,230.43 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	255,15 pikë
BOE Senka & G.P.G. Company	338,960,029.95 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	249,30 pikë
Curri	329,537,308 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	241,05 pikë
Arkonstudio	340,994,766.5 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	236,40 pikë
BOE Ante-Group & Nova Construction Group	407,016,484 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	209,10 pikë
Agi Kons	400,000,000.93 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	206,40 pikë
Salillari	430,000,000 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	205,65 pikë
BOE Aurora Konstruksion & Desaret Company	412,013,092.57 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	194,70 pikë
BOE Sterkaj & Eral Construction Company	425,411,174 lekë	Skualifikuar
Dion-Al	332,056,787.67 lekë	Skualifikuar
Llazo	340,064,565 lekë	Skualifikuar
BOE Fled & Shkelqimi 07	332,517,519.59 lekë	Skualifikuar
BOE Nika & Mane/S	350,144,481.68 lekë	Skualifikuar
BOE Lis Konstruksion & Viante Konstruksion	314,167,060.34 lekë	Skualifikuar
BOE Ergi shpk & BE - IS	400,846,043 lekë	Skualifikuar
BOE Kacdedja & Agri Construction	343,758,626.37 lekë	Skualifikuar
BOE Albavia & Inerti	394,279,157.91 lekë	Skualifikuar
Vellezerit Hysa	323,646,519.36 lekë	Skualifikuar

III.1.4. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.5 Në datën 14.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/6075 dhe me nr. protokollit 3269/2025, datë 14.11.2025, e operatorit

ekonomik “Zdrava” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr.3269/1 prot., datë 17.11.2025.

III.1.7 Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 4653 prot., datë 26.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3269/2 prot., datë 02.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin datë 25.11.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Zdrava” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.8 Në datën 03.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.192/2026 ku vendosi:

7. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
8. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
9. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.*
10. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK*
11. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
12. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.1.9. Me shkresën nr. 192/3 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr. 3269/9 prot., datë 19.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.192/2026 datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III.1.10. Në datën 19.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.286/2026, ku vendosi:

3. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit*
4. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.1.11. Në datën 26.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit në SPE sipas njoftimit të publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 17, datë 02.03.2026 si vijon:

*“... 3.Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64104-10-08-2025*

*4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Ndërtimi i infrastrukturës së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”.*

*6.Arsyet e Anulimit:*

*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:*

*...*

*X për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;...*

*7. Informacione shtesë:*

*Për shkak të pamundësisë financiare të Bashkisë për realizimin e procesit të shpronësimit, FSHZH nuk mund të vijojë me ecurinë e mëtejshme të procesit të prokurimit për finalizimin e kontratës dhe zbatimin e projektit.*

III.1.12. Në datën 02.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6376, si dhe nr. protokollit 662/2026 datë 02.03.2026 i operatorit ekonomik, “Zdrava” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit

III.1.13. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr.929 prot., datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me nr.662/2 prot., datë 17.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin datë 11.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Zdrava” SHA. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.14. Me shkresën nr.662/4 prot., datë 25.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor me shkresë duke i kërkuar informacionin si më poshtë: [...] *Aktualisht, nga*

*ana e autoritetit kontraktor është dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i KSHA datë 11.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

*Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, autoriteti kontraktor duhet të dërgojë pranë KPP, kopje të njësuar me origjinalin, të dokumentacionit që ka shërbyer për vendimarrjen e anulimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, e konkretisht:*

- *Marrëveshjen e bashkëpunimit midis FSHZH dhe Bashkisë Divjakë për realizimin e projektit objekt prokurimi;*
- *Shkresën e Bashkisë Divjakë nr.164 prot., datë 08.01.2026;*
- *Shkresën nr.137/1 prot., datë 16.01.2026 të FSHZH;*
- *Vendimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi;*
- *Çdo dokument tjetër që është përdorur në marrjen e vendimit për anulim [...].*

III.1.15. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me anë të shkresës nr.929/2 prot., datë 27.03.2026, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar me tonën me nr.662/5 prot., datë 30.03.2026, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kopje të njësuar me origjinalin të dokumentacionit të poshtëshënuar:

- *Marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkinë Divjakë nr. 10812/1 Prot., datë 15.10.2025, protokolluar nga FSHZH me nr. 4230/1 Prot., datë 15.10.2025;*
- *Shkresa e Bashkisë Divjakë nr. 164 Prot., datë 08.01.2026, protokolluar nga FSHZH me nr. 137, datë 12.01.2026;*
- *Shkresa e FSHZH-së nr. 137/1 Prot., datë 16.01.2026 drejtuar Bashkisë Divjakë;*
- *Shkresa FSHZH-së nr. 137/2 Prot. datë 27.02.2026 - 4 fletë;*
- *Urdhër për anulimin e procedurës së prokurimit me REF-64104-10-08-2025-1 fletë;*
- *Njoftimi i Anulimit në Buletin nr.17 datë 2 Mars 2026 - 1 fletë;*
- *Vendimi i KSHA dërguar me shkresën nr.329 prot., datë 12.03.2026.*

III.1.16. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe njoftimit të anulimit të publikuar në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 17, datë 02.03.2026, KPP konstaton se,

III.1.17. Më datë 14.10.2025 autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Divjakë, për projektin “*Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë*”, ku në nenin 2 të saj është përcaktuar objekti i kësaj marrëveshje , e më konkretisht: *Objekti i kësaj marrëveshje është angazhimi i palëve në zhvillimin e Projektit: "Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë" (në vijim "Projekti"), me vendndodhje në lindje të zonës urbane të Bashkisë Divjakë, ku zona e ndërhyrjes ka një sipërfaqe prej 40 Ha dhe shtrirje lineare me drejtim Veri-Jug në një gjatësi rreth 1.85 km, projekt me vendimarrjen përkatëse të Këshillit Bashkiak Divjakë. Po ashtu, në nenin 4 “Angazhimet e Bashkisë Divjakë” të kësaj marrëveshjeje është përcaktuar: “4.1.Bashkia Divjakë angazhohet që të kryejë të gjitha veprimet*

dhe të ndërmarrë të gjitha masat për zhvillimin e projektit "Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë" sipas projektit me vendimmarrjen përkatëse të Këshillit Bashkiak Divjakë.

4.2 Bashkia Divjakë për të bërë të mundur realizimin e objektit të kësaj marrëveshje, angazhohet: a) të realizojë, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, procesin e shpronësimit dhe të marrjes në përdorim të pasurisë pronë private për interes publik, në përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe të sigurojë vendosjen e saj në funksion të zbatimit të projektit...".

Me shkresën nr.164 prot., datë 08.01.2026, me objekt "Kërkesë për marrjen në konsideratë të kostove të shpronësimit të rrënjve të ullinjve dhe sipërfaqes së tokës në kuadër të projektit që zbatohet në Bashkinë Divjakë me objekt "Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të ullishteve, Divjakë", Bashkia Divjakë i drejtohet me kërkesë autoritetit kontraktor, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), për të përfshirë në koston e projektit edhe kostot e shpronësimit, me pretendimin se Bashkia Divjakë është në pamundësi financiare për realizimin e procesit të shpronësimit konkretisht: [...] Bashkia Divjakë, pas analizimit të situatës financiare dhe buxhetore, ju bën me dije se nuk ka mundësi reale për të përballuar me fondet e veta kostot e shpronësimit, për shkak të kufizimeve buxhetore dhe angazhimeve të tjera financiare të miratuara për vitin buxhetor përkatës, Këto kosto janë të konsiderueshme dhe tejkalojnë kapacitetet financiare të bashkisë.

Në këto kushte, duke qenë se projekti zbatohet me financim dhe koordinim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si dhe në funksion të garantimit të vijueshmërisë dhe përfundimit me sukses të tij, kërkojmë nga ana juaj marrjen në konsideratë dhe përfshirjen e kostove të shpronësimit,[...].

Me shkresën nr.137/1 prot., datë 16.01.2026, autoriteti kontraktor i kthen përgjigje Bashkisë Divjakë lidhur me kërkesën e sipërcituar (përfshirjen në koston e projektit edhe kostot e shpronësimit), duke e vënë në dijeni se FSHZH nuk mund të financojë shpronësimet e konkretisht: [...] FSHZH mbështetur në programe e saj të zhvillimit nuk ka kompetencë për financimin e vlerës së shpronësimit, pasi pjesë e këtyre programeve është vetëm financimii vlerës së zbatimit të projektit, projektimi, mbikqyrja dhe kolaudimi, ndërsa procedurat e shpronësimit ndiqen nga institucionet përkatse me ASHSH-në.[...].

Në vijim të komunikimit me Bashkinë Divjakë, autoriteti kontraktor më shkresën nr.137/2 prot., datë 27.02.2026, me objekt "Përcjellje e planimetrisë së rishikuar dhe vijimi i procedurave të shpronësimit për projektin "Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë", bën me dije Bashkinë Divjakë se ka ndërmarrë masa për rishikimin e projektit të zbatimit me qëllim optimizimin e gjurmës së ndërhyrjes dhe reduktimin e sipërfaqes të nevojshme për shpronësim duke cituar [...] Si rezultat i këtij rishikimi është përgatitur planimetria e përditësuar e projektit, të cilën e gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese. Ndryshimet e propozuara reduktojnë në mënyrë të konsiderueshme gjurmën e ndërhyrjes dhe rrjedhimisht, ulin më rreth 90 % sipërfaqen e nevojshme për shpronësim për interes publik, me ndikim të drejtëpërdrejtë në detyrimet financiare të nevojshme për realizimin e këtij procesi [...]. Në datën 26.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.18. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.19 Në nenin 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
  - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
  - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
- 2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
- 3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
- 4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit dhe publikon njoftimin e anulimit. 5. Shfuqizuar

III.1.20 Në nenin 38 “Njoftimi i Anulimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoriteti/enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.
- 2. Njoftimi i anulimit duhet të përmbajë të paktën:
  - emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
  - numrin e referencës së procedurës;
  - objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);

- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;

- arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.”

III.1.21. Lidhur me pretendimin e ankimesit, i cili kërkon shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi si të pabazuar në ligj, Komisioni vëren se,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në datë 14.10.2025 ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Divjakë për realizimin e projektit “Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë”. Në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet objekti i saj, ndërsa në nenin 4 parashikohen detyrimet e Bashkisë Divjakë, ku ndër të tjera kjo e fundit angazhohet të realizojë, përpara fillimit të punimeve, procesin e shpronësimit të pasurive private për interes publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me shkresën nr. 164 prot., datë 08.01.2026, Bashkia Divjakë i është drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar përfshirjen në koston e projektit të shpenzimeve për shpronësim, duke argumentuar pamundësinë financiare për përballimin e tyre. Në përgjigje, me shkresën nr. 137/1 prot., datë 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka sqaruar njësinë vendore Bashkinë Divjakë, se nuk ka kompetencë për financimin e kostove të shpronësimit, pasi këto nuk përfshihen në programet e tij të financimit. Në vijim, me shkresën nr. 137/2 prot., datë 27.02.2026, autoriteti kontraktor ka bërë me dije se është ndërmarrë rishikimi i projektit me qëllim reduktimin e sipërfaqes së nevojshme për shpronësim, duke ulur atë në mënyrë të konsiderueshme. Në këto kushte, në datën 26.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit.

Komisioni gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Nga analiza e rrethanave sa më sipër rezulton se, realizimi i projektit “Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë”, është i kushtëzuar nga kryerja e procesit të shpronësimit, i cili është një kusht i domosdoshëm për fillimin e punimeve. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë 14.10.2025 detyrimi për realizimin e këtij procesi i takon Bashkisë Divjakë. Kjo e fundit, më datë 08.01.2026, gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor, ka njoftuar autoritetin kontraktor për pamundësinë financiare për realizimin e shpronësimeve. Nërkojë, autoriteti kontraktor ndodhur në kushtet e pamundësisë financiare të njësisë vendore për shpronësim dhe moskompetencës së vet për të financuar këto kosto ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, pamundësia e njësisë vendore për realizimin e shpronësimit, e cila ka qenë dhe arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, është një rrethanë objektive e pavarur nga vullneti i autoritetit kontraktor, rrethanë e cila e bën të pamundur vijimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimin e kontratës, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.. KPP gjykon se ndër parimet kryesore të prokurimit publik është parimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të vepruarit me transparencë e në mënyrë proporcionale. Lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor, nga

shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ Komisioni vlerëson, se autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë ligjërisht dhe të provojë me dokumentacion provues, se cilat janë rrethanat detyruese për të cilat, është marrë edhe vendimi i anulimit të kësaj procedure ankimimi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbështetës ligjor dhe teknik, mbi arsyen e anulimit. Komisioni vlerëson se mungesa e realizimit të shpronësimeve si kusht thelbësor për realizimin e projektit “Ferma e Dijes dhe Agroturizmit të Ullishteve Divjakë”, e bën të pamundur zbatimin e kontratës. Sa më sipër, Komisioni gjykon se anulimi i procedurës së prokurimit është bërë në përputhje me nenin 98, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Zdrava” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nenkryetar**  
**Fiorent Zguro**

